



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.671/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullësive gjatë ditës së votimit, në vendvotimin 2114B/04D, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura më datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Subjektit Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullësive gjatë ditës së votimit, në vendvotimin 2114B/04D, për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë Subjektit Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Skenderaj, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se në vendvotimin numër 2114B/04D, gjatë procesit të votimit janë shënuar dy raste të fotografimit të votës dhe të dyshuarit për kryerjen e këtyre veprimeve janë arrestuar nga policia dhe se rastet janë shënuar edhe në Librin e Vërejtjeve në këtë vendvotim.

Më tej në ankesë theksohet se këto veprime të kundërligjshme dëshmojnë blerjen e votës, nga ana e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës-PDK.

Parashtruesi i ankës shton se personat e raportuar të cilët kanë fotografuar votën janë Kushtrim Tahiri dhe Adem Xhemali, dhe kërkojnë që të ndërmerren masa ligjore ndaj tyre.

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij ka bashkangjitur deklaratën e Azem Mecini, komisioner nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar me datë 17.10.2021, në vendvotimin

numër 2114B/04D, gjatë procesit të votimit kanë bërë fotografimin e votës dhe se të njëjtit janë arrestuar nga Policia e Kosovës.

Nga raporti i Policisë së Kosovës, i datës 17.10.2021, paneli konstatoi se pretendimet në ankesë janë të pabazuara lidhur me fotografimin e votës në vendvotimin 2214B në Shkollën Fillore “Shotë Galica” në Runik, ku thuhet se në vendin e ngjarjes ishte përgjigjur një njësi policore mirëpo, nuk është vërtetuar se ka pasur tentim të fotografimit të votës, rrjedhimisht nuk ka rast të iniciuar në drejtim të ndonjë vepre penale, dhe se lidhur me rastin ka qenë e njoftuar edhe prokurorja e cila ka qenë e caktuar për ditën e zgjedhjeve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.671/2017 më datën 20.10.2021.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.